


Dalës-Izjava

Nr. 11-1337
Br.

Data 26.09.2023
Datum

OBILIQ-OBILIC



**KOMUNA E
OBILIQIT**



**KOMUNA E
PRISHTINËS**

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Komunës së Obiliqit

dhe

Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtina

për

**“REALIZIMIN E PROJEKTIT TË NGROHJES
DIELLORE “SOLAR4KOSOVO”**

2023

Neni 1
Palët Nënshkruese

- 1.1 Komuna e Obiliqit, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi; dhe
- 1.2 Kryeqyteti i Republikës së Kosovës, Prishtina, të cilën e përfaqëson Kryetari i Kryeqytetit, Përparim Rama

Neni 2
Qëllimi i Marrëveshjes

- 2.1 Qëllimi i kësaj marrëveshjeje në mes palëve nënshkruese është sigurimi i lokacionit për projektin të Ngrohjes Diellore “Solar4Kosovo”, në fshatin Shkabaj (Hade e Re), e cila sipas ekspertëve të fushës është përcaktuar si vend ideal për të njëjtin projekt dhe i njëjti do të vendoset në parcelat:
 - 2.1.1 -P-72614046-00612-1 ;Zona Kadastrale: Mazgit; Sipërfaqja :41702 m²; e evidentuar në emër të NP. “TERMOKOS” Pjesa e pronës 1/1;
 - 2.1.2 -P-72614046-00612-2 ;Zona Kadastrale: Mazgit; Sipërfaqja :1494 m²; e evidentuar në emër të NP. “TERMOKOS” Pjesa e pronës 1/1;
 - 2.1.3 -P-72614055-01879-472 ;Zona Kadastrale: Obiliq; Sipërfaqja :21644 m²; e evidentuar në emër të NP. “TERMOKOS” Pjesa e pronës 1/1 dhe;
 - 2.1.4 -P-72614055-01879-474; Zona Kadastrale: Obiliq; Sipërfaqja :289551m² e evidentuar në emër të NP. “TERMOKOS” Pjesa e pronës 1/1.
- 2.2 Komuna e Prishtinës merr përgjegjësinë që të kryejë obligimet financiare që do të dalin nga procesi i shpronësimit të pronave të cekura në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 3
Lista e parcelave që do t'i nënshtrohen procesit të shpronësimit

- 3.1 -P-72614041-00024/1; Zona Kadastrale: Llazarevë; Tipi i pronës : Pronë Shoqërore Vendi i quajtur : Fusha e këthjellët ; Sipërfaqja : 7353 m² ; Shfrytëzimi aktual / kultura: Bujqësore – Arat-Arë e klasës – 5 ; Pjesa e Pronës 1/1 ;
- 3.2 -P-72614041-00024/2; Zona Kadastrale: Llazarevë; Tipi i pronës: Pronë Shoqërore ;Vendi i quajtur : Fusha e këthjellët ; Sipërfaqja : 4552 m² ; Shfrytëzimi aktual / kultura: Bujqësore – Arat-Arë e klasës – 5; Pjesa e Pronës 1/1 ;
- 3.3 -P-72614041-00025/1; Zona Kadastrale: Llazarevë; Tipi i pronës : Pronë Private ;Vendi i quajtur : Fusha e këthjellët ; Sipërfaqja : 5517 m² ; Shfrytëzimi aktual / kultura: Bujqësore – Arat-Arë e klasës – 5 ; Pjesa e Pronës 1/1;
- 3.4 -P-72614041-00026/1; Zona Kadastrale: Llazarevë; Tipi i pronës : Pronë Shoqërore ;Vendi i quajtur : Fusha e këthjellët ; Sipërfaqja : 10890 m² ; Shfrytëzimi aktual / kultura: Bujqësore – Arat-Arë e klasës – 5 ; Pjesa e Pronës 1/1;

- 3.5 -P-72614041-00026/2; Zona Kadastrale: Llazarevë; Tipi i pronës : Pronë Shoqërore ;Vendi i quajtur : Fusha e këthjellët ; Sipërfaqja : 3996 m² ; Shfrytëzimi aktual / kultura: Bujqësore – Arat-Arë e klasës – 5 ; Pjesa e Pronës 1/1;
- 3.6 -P-72614041-00028/0; Zona Kadastrale: Llazarevë; Tipi i pronës : Pronë Shoqërore ;Vendi i quajtur : Fusha e këthjellët ; Sipërfaqja : 19022 m² ; Shfrytëzimi aktual / kultura: Bujqësore – Arat-Arë e klasës – 5 ; Pjesa e Pronës 1/1;
- 3.7 -P-72614041-00031/0; Zona Kadastrale: Llazarevë; Tipi i pronës : Pronë Shoqërore ;Vendi i quajtur : Tërshevina ; Sipërfaqja : 13884 m² ; Shfrytëzimi aktual / kultura: Bujqësore – Arat-Arë e klasës – 4 ; Pjesa e Pronës 1/1;
- 3.8 -P-72614041-00032/1; Zona Kadastrale: Llazarevë ; Tipi i pronës : Pronë Shoqërore ;Vendi i quajtur : Tërshevina ; Sipërfaqja : 37414 m² ; Shfrytëzimi aktual / kultura: Bujqësore – Arat-Arë e klasës – 4 ; Pjesa e Pronës 1/1;
- 3.9 -P-72614041-00032/2; Zona Kadastrale: Llazarevë ; Tipi i pronës : Pronë Shoqërore ;Vendi i quajtur : Tërshevina ; Sipërfaqja : 22218 m² ; Shfrytëzimi aktual / kultura: Bujqësore – Arat-Arë e klasës – 4 ; Pjesa e Pronës 1/1;
- 3.10 -P-72614041-00033/0; Zona Kadastrale: Llazarevë ; Tipi i pronës : Pronë Shoqërore ;Vendi i quajtur : Tërshevina ; Sipërfaqja : 30795 m² ; Shfrytëzimi aktual / kultura: Bujqësore – Arat-Arë e klasës – 4 ; Pjesa e Pronës 1/1;
- 3.11 -P-72614041-00034/1; Zona Kadastrale: Llazarevë ; Tipi i pronës : Pronë Shoqërore ;Vendi i quajtur : Tërshevina ; Sipërfaqja : 20000 m² ; Shfrytëzimi aktual / kultura: Bujqësore – Arat-Arë e klasës – 4 ; Pjesa e Pronës 1/1;
- 3.12 -P-72614041-00035/1; Zona Kadastrale: Llazarevë ; Tipi i pronës : Pronë Shoqërore ;Vendi i quajtur : Fusha e hapur ; Sipërfaqja : 36096 m² ; Shfrytëzimi aktual / kultura: Bujqësore – Arat-Arë e klasës – 4 ; Pjesa e Pronës 1/1;
- 3.13 -P-72614041-00036/1; Zona Kadastrale: Llazarevë ; Tipi i pronës : Pronë Shoqërore ;Vendi i quajtur : Tërshevina te Llazareva ; Sipërfaqja : 5994 m² ; Shfrytëzimi aktual / kultura: Bujqësore – Arat-Arë e klasës – 3 ; Pjesa e Pronës 1/1;
- 3.14 -P-72614041-00036/2; Zona Kadastrale: Llazarevë ; Tipi i pronës : Pronë Shoqërore ;Vendi i quajtur : Tërshevina te Llazareva ; Sipërfaqja : 5300 m² ; Shfrytëzimi aktual / kultura: Bujqësore – Arat-Arë e klasës – 3 ; Pjesa e Pronës 1/1;
- 3.15 -P-72614051-00226/0; Zona Kadastrale: Milloshevë ; Tipi i pronës : Pronë Shoqërore ;Vendi i quajtur : Jezero ; Sipërfaqja : 120229 m² ; Shfrytëzimi aktual / kultura: Bujqësore – Arat-Arë e klasës – 6 ; Pjesa e Pronës 1/1;

- 3.16 Të gjitha parcelat e cekur në nenin 3 në regjistrat kadastral figurojnë në emër të KBI EXPORT–N.SH. BUJQËSIA, të cilat menaxhohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Neni 4 **Obligimet e Komunës së Obiliqit**

- 4.1 Meqenëse njësitë kadastrale të cekura në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje shtrihen brenda territorit të Komunës së Obiliqit, Komuna e Obiliqit do të zhvillojë të gjitha procedurat e shpronësimit sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.2 Bartja e pronësisë për njësitë kadastrale të cekura në neni 3 të kësaj marrëveshjeje nga KBI EXPORT–N.SH. BUJQËSIA në pronësi të Komunës së Obiliqit do të bëhet me Vendim Përfundimtar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, pas përfundimit të të gjitha procedurave të shpronësimit përkatësisht pagesës përfundimtare nga Komuna e Prishtinës.
- 4.3 Regjistrimi i parcelave të përshkruara në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje do të regjistrohen në pronësi të Komunës së Obiliqit, nga drejtoria përkatëse e Komunës së Obiliqit.

Neni 5 **Obligimet e Komunës së Prishtinës**

- 5.1 Komuna e Prishtinës do të nxjerrë konfirmim përmes të cilit zotohet se do të ketë mjete të mjaftueshme për pagesë që do të dalin nga procedura e shpronësimit dhe në përputhje me raportin e vlerësimit do t'i bartë mjetet financiare për të cilat ka marrë obligim nëpërmjet kësaj marrëveshjeje.
- 5.2 Komuna e Prishtinës obligohet që në emër të kësaj marrëveshjeje të nënshkruaj marrëveshjeje tjera me Komunën e Obiliqit, në interes të përbashkët, në fushat si më poshtë:
- 5.2.1 Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
 - 5.2.2 Shërbime Publike dhe Emergjencja;
 - 5.2.3 Kulturë, Rini dhe Sport;
 - 5.2.4 Arsim;
 - 5.2.5 Bujqësi;
 - 5.2.6 Infrastrukturë Lokale dhe
 - 5.2.7 Fusha tjera që lidhen me ushtrimin e kompetencave vetanake të komunave.
- 5.3 Komuna e Prishtinës do të jetë përgjegjëse për të investuar në ndërtimin e infrastrukturës të domosdoshme në lokacionin e shpronësuar sipas nevojave përkatësisht projektit të Komunës së Obiliqit.
- 5.4 Nëse projekti i ngrohjes diellore “Solar4Kosovo” për arsye të ndryshme nuk mund të fillojë të realizohet, Komuna e Prishtinës obligohet që parcelat e cekura në nenin 2.1 të kësaj marrëveshjeje t'i liroj dhe t'i kthej në gjendjen e mëparshme.

Neni 6
Vlefshmëria e Marrëveshjes

- 6.1 Marrëveshja është me karakter obligativ për palët dhe krijon detyrime ligjore për palët nënshkruese.
- 6.2 Marrëveshja është e vlefshme dhe prodhon efekte juridike deri në momentin e finalizimit të projektit të shpronësimit.
- 6.3 Me pëlqimin paraprak të palëve kjo marrëveshje mund të ndryshohet dhe të plotësohet.
- 6.4 Palët mbajnë të drejtën e shkëputjes së kësaj marrëveshjeje në rast se konstatojnë se nuk po përmbushen obligimet dhe qëllimi i kësaj marrëveshjeje.
- 6.5 Në rast të kontestit, palët mund të zgjidhin mosmarrëveshjet edhe në procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente.

Neni 7
Hyrja në fuqi

- 7.1 Kjo marrëveshje fillon zbatimin pasi që të merr miratimin nga Kuvendi i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës si dhe nga Kuvendi Komunal i Obiliqit, në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal.
- 7.2. Kjo Marrëveshje është lidhur në pajtim me vendimin e Kuvendit të Kryeqytetit, Prishtinës me nr. 01-020/02-177566, të datës 26.07.2023 si dhe të vendimit të Kuvendit Komunal të Obiliqit me nr. prot. -1-179 të datës 29.12.2022.
- 7.3 Kjo marrëveshje do të nënshkruhet në katër (4) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga dy (2) kopje për secilën palë.

Xhafer Gashi
Kryetar
Komuna e Obiliqit



Përparim Rama
Kryetar
Kryeqyteti i Republikës së Kosovës,
Prishtina

